



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**AUTORITETI I KONKURRENCËS**  
**DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE**

### NJOFTIM

**Rasti:** Përftimi i kontrollit të shoqërisë SelfNest d.o.o. nga shoqëria Nelt Co. d.o.o Dobanovci.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr.630 prot., i AK, datë 25.10.2022, “Njoftim Përqendrimi”, me të cilën jemi njoftuar mbi transaksionin e përftimit të kontrollit të shoqërisë SelfNest d.o.o. nga shoqëria Nelt Co. d.o.o Dobanovci.

Referuar marrëveshjes, palët janë:

**Blerësi: Nelt Co. d.o.o Dobanovci**, është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit serb, me objekt aktiviteti: tregtia me shumicë e sheqerit dhe çokolletës dhe e produkteve të sheqerit; distribucioni dhe tregtia me shumicë e mallrave, logjistika dhe marketingu tregtar te konsumatori. Nelt Co. D.o.o. i përket grupit të shoqërive Nelt. Shoqëria mëmë e grupit Nelt është shoqëria Neregelia Trading Limited, e cila realizon të ardhura dhe është prezentë në Shqipëri nëpërmjet filialit të zotëruar tërësisht prej saj, Nelt SHPK.

**Shitësi: Dejan Čogurić**, person fizik, shtetas i huaj, i cili zotëron 100% SelfNest d.o.o.

**Target: SelfNest d.o.o.** është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit serb, me objekt aktiviteti zhvillimi i projekteve të ndërtimit si dhe çdo aktivitet tjetër ekonomik pasi të ketë përmbushur kërkesat e duhura ligjore. SelfNest është kryesisht aktiv në zhvillimin e projekteve të ndërtimit në Serbi.

SelfNest nuk është prezente dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**